

ALBANA MEMA

**INSTITUCIONET PËRFAQËSUESE NË SHQIPËRI
1920-1924**

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I HISTORISË



ALBANA MEMA

**INSTITUCIONET PËRFAQËSUESE
NË SHQIPËRI
1920-1924**

Tiranë, 2021

Titulli:

Institucionet përfaqësuese në Shqipëri (1920-1924)

Autor:

ALBANA MEMA

Recensentë: **Akademik prof. dr. Beqir META**

Phd. Liridon LIKA

Korrektore gjubësore: Mimoza KONOMI

Përpunimi teknik & Arti Grafik: Mirela MIHALI

Kopertina: Dorina MUKA

Foto në kopertinë: Ndërtesa e Parlamentit të parë Shqiptar

https://en.wikipedia.org/wiki/Parliament_of_Albania#/media/File:Nd%C3%ABrtesa_e_Parlamentit_t%C3%AB_Par%C3%AB_Shqiptar.jpg

© Autori & Akademia e Studimeve Albanologjike / Instituti i Historisë

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

ISBN 978-9928-289-74-2

Botimet albanologjike

Tiranë, 2021

PASQYRA E LËNDËS

<i>Parathënie</i>	11
<i>Hy r j e</i>	15
Trashëgimia e institucioneve politike përfaqësuese.....	15

KREU I

KONGRESI I LUSHNJËS	31
- Zhvillimet që sollën mbledhjen e Kongresit të Lushnjës	31
- Kongresi i Lushnjës - sfida e parë kundër politikës italiane	35
- Afirmimi i institucioneve të dala nga Kongresi i Lushnjës.....	42
- Natyra juridike e Kongresit të Lushnjës.....	47
- Veprimtaria e Kongresit të Lushnjës	50
<i>Veprimtaria ligjvënëse e Kongresit të Lushnjës</i>	51
<i>“Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë” ose Statuti i Lushnjës (1920)</i> . 57	
- Institucionet dhe forma e qeverisjes sipas Statutit të Lushnjës.....	61
<i>Parimet themelore dhe forma e regjimit</i>	61
<i>Institucioni i Kryetarit të Shtetit- Këshilli i Naltë</i>	67
<i>Institucioni i pushtetit ekzekutiv - Qeveria</i>	69
<i>Institucioni i pushtetit legjislativ - Këshilli Kombëtar (Senati)</i>	70
- Rezultatet e Kongresit të Lushnjës	72

KREU II**PËRPFJEKJET PËR AFIRMIMIN E SHTETIT SHQIPTAR
DHE TË INSTITUCIONEVE TË TIJ NË ARENËN****NDËRKOMBËTARE 81**

- Pozita ndërkombëtare e Shqipërisë deri në vjeshtën e vitit 1920 81
- Shteti shqiptar para Lidhjes së Kombeve..... 83
- Procesi i afirmimit të pavarësisë në Lidhjen e Kombeve dhe Konferencën e Ambasadorëve 92
- Ballafaqimi me politikën greke dhe jugosllave në procesin e ndërtimit të institucioneve kombëtare 112
- Sabotimi i zgjedhjeve të para politike të vitit 1921 115
- Ndikimi i propagandës dhe i presionit grek në qarqet nacionaliste shqiptare..... 117
- Lëvizja vorio-epirote si mjet presioni kundër institucioneve kombëtare shqiptare..... 119
- Kërcënimet me luftë deri në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve..... 120
- Instrumentet dhe argumentet e politikës greke..... 124
- Sfidat greke kundrejt kombëtarizimit të institucioneve fetare dhe çështjes së minoritetit..... 133
- Gjallërimi i presionit grek në momentet e krizave që kaloi shteti shqiptar..... 135

KREU III**ZGJEDHJET POLITIKE TË VITIT 1921 137**

- Debat i publik në prag të zgjedhjeve të vitit 1921 dhe komentet mbi ligjin e zgjedhjeve..... 137
- Grupet kryesore politike pjesëmarrëse në zgjedhje 144
- Qëndrimi i qeverisë ndaj zgjedhjeve 148
- Tendencat kantonale gjatë zgjedhjeve..... 149
- Ballafaqimet politike gjatë fushatës zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve..... 157

- Vlerësimet e zgjedhjeve të vitit 1921 nga historiografia shqiptare 164

KREU IV

ZGJEDHJET PËR ASAMBLENË KUSHTETUESE NË VITIN 1923 DHE ZGJEDHJET E SHPALLURA NGA QEVERIA E NOLIT NË VITIN 1924 167

- Situata parazgjedhore, ligji i zgjedhjeve dhe ballafaqimet rreth tij. 167
- Fushata zgjedhore dhe forcat politike në zgjedhjet e dhjetorit 1923 178
- Rezultati i zgjedhjeve dhe reagimi i forcave politike 183
- Zgjedhjet e shpallura nga qeveria e Nolit në vitin 1924..... 190

KREU V

KËSHILLI KOMBËTAR (SENATI) I ZGJEDHUR NGA KONGRESI I LUSHNJËS 201

- Aktiviteti i Këshillit Kombëtar 201
- Tëporet dhe kufizimet e Parlamentit Shqiptar..... 209
- Dorëheqja e qeverisë dhe shpërndarja e Këshillit Kombëtar..... 218

KREU VI

PARLAMENTI I PARË SHQIPTAR I DALË NGA ZGJEDHJET POLITIKE TË VITIT 1921 223

- Konstituimi i Parlamentit, Partitë politike parlamentare 223
- Veprimtaria e Parlamentit gjatë muajve të parë..... 232
- Fluiditeti i Parlamentit - krijimi i koalicionit ndërpartiak “Bashkimi i Shenjtë” 240
- Thellimi i krizës parlamentare dhe qëndrimi i Parlamentit përballë grushtit të shtetit të dhjetorit 1921 249
- Komentet mbi veprimtarinë e Parlamentit pas grushtit të shtetit. 266
- Vlerësimet e diplomatëve britanikë lidhur me veprimtarinë e Parlamentit gjatë krizës së dhjetorit 1921..... 269

- Dënimi i deputetëve pjesëmarrës në lëvizjen e marsit nga Parlamenti 278
- Debati në parlament për thirrjen e Asamblesë Kushtetuese 282
- Diskutimi dhe miratimi i Statutit të Zgjeruar të Lushnjës (14 dhjetor 1922) 287
- Kontributi i Parlamentit në ngritjen e sistemit gjyqësor 305
- Rezultatet e punës së Parlamentit gjatë vitit 1922 310
- Parlamenti në sesionet e vitit 1923 316

KREU VII

ASAMBLEJA KUSHTETUESE E VITIT 1924..... 333

- Shpresa të mëdha por edhe dyshime për rezultatet e Asamblesë Kushtetuese në fillim të aktivitetit të saj..... 335

KREU VIII

FILLESAT E LËVIZJES OPOZITARE NË SHQIPËRI NË VITET 1920-1921 355

- Opozita jashtë institucioneve politike që krijoi Kongresi i Lushnjës dhe fillimet e opozicionit kushtetues 357
- Irredentizmi-boshti i parë i opozitës..... 360
- Opozicioni pas zgjedhjeve të vitit 1921, krijimi i koalicionit fals “Bashkimi i Shenjtë” 366
- Opozicioni i dhunshëm-grushti i shtetit në dhjetor 1921 dhe krijimi i opozitës së parë ligjore..... 370

KREU IX

AKTIVITETI POLITIK I OPOZITËS NË VITET 1922-1923. 375

- Opozita në rebelimin e marsit 1922..... 376
- Opozita pas kryengritjes së marsit 1922..... 390
- Opozita pas ardhjes së Ahmet Zogut në krye të qeverisë 398
- Rishfaqja e opozitës së dhunshme 403
- Opozita në sesionin parlamentar të pranverës së vitit 1923..... 406

- Përgatitjet për një grusht shteti në verën e vitit 1923 dhe opozita në seancën e fundit të Parlamentit..... 408
- Pikëpamjet në historiografi për opozitën e vitit 1923 418

KREU X

OPOZITA GJATË DHE PAS ZGJEDHJEVE

PËR ASAMBLENË KUSHTETUESE 423

- Opozita në zgjedhjet e vitit 1923..... 423
- Opozita pas zgjedhjeve - konflikti politik e ushtarak 430
- Vlerësimet kryesore të historiografisë për kryengritjen e qershorit 1924 446

Burimet dhe bibliografia 453

Treguesi i emrave dhe i vendeve 469

PARATHËNIE

Të zbulosh e të analizosh se cila ka qenë rruga që kanë ndjekur institucionet e shtetit shqiptar, në përpjekjet për ngritjen dhe konsolidimin e tyre dhe njëkohësisht të demokracisë parlamentare në Shqipëri, në vitet 1920-1924, është një detyrë e vështirë dhe një hap më tepër për të kontribuar në historiografinë e kësaj periudhe. Pikërisht ky është fokusi i këtij studimi. Në këtë këndvështrim, është e domosdoshme të theksohet se, analiza e krijimit dhe e veprimtarisë së institucioneve në këtë periudhë, është bërë në raport me përputhshmërinë e tyre me dispozitat ligjore të kohës dhe me nevojën për konsolidimin e shtetit, e cila ishte kryefjala e prioriteteve të Shqipërisë së asaj kohe. Ky ka qenë boshti metodologjik nga jemi nisur për shkrimin e kësaj monografie.

Qëllimi i këtij studimi është analiza e rolit dhe e pozitës së institucioneve përfaqësuese në Shqipëri si në marrëdhëniet e tyre me institucionet e tjera politike, ashtu edhe në raport me qytetarët dhe shtetin si etnitet politik.

Përkufizimi i shtetit të së drejtës ndryshon sipas epokave dhe autorëve. Shteti i së drejtës është, para së gjithash, një model teorik. Ai është bërë një temë themelore e politikës meqenëse konsiderohet si karakteristika kryesore e regjimit demokratik. Sipas një përkufizimi më të vjetër, shteti i së drejtës, është një sistem institucional në të cilin fuqia publike i nënshtrohet së drejtës. Ai është shumë i lidhur me respektimin e hierarkisë së normave, me ndarjen e pushteteve, barazinë e subjekteve të së drejtës para normave juridike, ekzistencën e juridiksioneve të pavarura dhe garantimin e të drejtave civile dhe politike të individëve. Pra, shteti i së drejtës, është kështjella institucionale që përmbledh të gjitha institucionet juridikisht të bazuara tek kushtetuta dhe ligjet.

Kriter themelor metodologjik i këtij studimi është raporti i ngjarjeve apo figurave historike me detyrat themelore që do të zgjidhte shteti shqiptar në këto vite. Çdo institucion dhe çdo ngjarje është vlerësuar në raport me kushtetutshmërinë e tyre dhe në funksion të nevojës jetike dhe emergjente të ndërtimit dhe stabilizimit të shtetit në këtë periudhë.

Në hartimin e studimit është zbatuar kriteri tematiko-kronologjik. Kriteri tematik është përdorur për të përcaktuar kapitujt dhe brenda këtyre të fundit, kriteri kronologjik. Gjatë përgatitjes së studimit, duke pasur parasysh edhe karakterin historik e juridik të tij, jemi konsultuar dhe me studiues të tjerë të periudhës, që kanë kontribuar në këtë fushë.

Në këtë studim, formimi i institucioneve përfaqësuese është trajtuar në kuadrin historik të kohës, në lidhje të ngushtë me zhvillimet politike, ekonomike, fetare, shoqërore, arsimore etj. Periudha 1920-1924 ishte një etapë vendimtare në historinë shqiptare, kur u ngritën institucionet kombëtare me karakter të plotë vetëqeverisës të shtetit shqiptar.

Studimi nis me Kongresin e Lushnjës, i cili ishte themeli i zhvillimit institucional të shtetit shqiptar, për të vijuar më tej, me përpjekjet e shqiptarëve për afirmimin e karakterit kombëtar, unik dhe të centralizuar të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare. Janë analizuar gjithashtu edhe institucionet themelore përfaqësuese në ecurinë dhe konsolidimin e demokracisë në vend, si: Parlamenti dhe institucioni i zgjedhjeve. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe aktorëve politikë në vend, duke studiuar të gjitha organizatat politike dhe jopolitike që vepruan në këtë periudhë. Edhe institucioni i opozitës, si përfaqësuese e vullnetit të një pjese të popullit dhe kontrolluese e qeverisjes, është analizuar gjithashtu në raport me qëndrimet e mbajtura në procesin e vështirë të konsolidimit të shtetit shqiptar.

Institucionet qeverisëse ekzekutive që vepruan në Shqipëri në këtë periudhë janë objekt i një studimi të veçantë.

Si burime themelore për hartimin e këtij studimi kemi shfrytëzuar gjerësisht materialet arkivore. Spikat si një burim i dorës së parë dokumentacioni i gjendur në arkivat kryesore të vendit, në Arkivin Qendror të Shtetit, në të cilin kemi parë fondet që kanë të bëjnë me

institucionet kryesore dhe aktorët politikë që vepruan në këtë periudhë, në Arkivin e Institutit të Historisë dhe në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe arkivave të diplomacive të huaja, veçanërisht Arkivave Kombëtare të Britanisë së Madhe (The National Archives) Fondi i Foreign Office (FO) dhe Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë (Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri (ASD MAE), Roma, të cilat tashmë shfrytëzohen si arkiva digjitale të Institutit të Historisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA). Hulumtimi i këtyre arkivave i ka dhënë një dimension të ri studimit, duke sjellë risi në perceptimin e ngjarjeve, personave dhe sidomos veprimtarisë së institucioneve të shtetit shqiptar në këtë periudhë, nën optikën e fuqive dhe diplomatëve të huaj.

Një vend qendror në burimet e këtij studimi zënë botimet zyrtare të viteve 1920-1924, ku një rëndësi të veçantë i kemi kushtuar Bisedimeve të Parlamentit në këto vite, Fletoreve Zyrtare dhe Qarkoreve të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Gjithashtu, janë analizuar me hollësi edhe aktet kushtetuese të kësaj periudhe: “Bazat e Kanunores së Këshillit të Naltë” dhe “Zgjanimi i Shtatutit të Shtetit Shqiptar” i vitit 1922. Janë analizuar gjithashtu, programet, kanunoret, rregulloret e partive politike të kësaj periudhe dhe organizatave të tjera jopolitike si dhe programet e qeverive të ndryshme. Është studiuar edhe një bibliografi e gjerë, e autorëve vendas dhe të huaj, dokumente të botuara, kujtime të bashkëkohësve, shtypi i kohës etj.

Gjatë trajtimit të kësaj teme, jemi përpjekur të evidentojmë problemet e diskutuara nga historiografia shqiptare e mëparshme dhe ajo e sotme, duke dhënë, sipas rastit, dhe mendimin tonë rreth objektivitetit apo qëndrimeve të tyre. Po në këtë mënyrë, janë analizuar dhe shfrytëzuar edhe veprat e autorëve të huaj.

Në përfundim, dëshiroj të shpreh falënderime të veçanta dhe mirënjohjen time të thellë për recensentët e punimit. Një falënderim i veçantë shkon për akademik Beqir Metën, i cili me profesionalizmin, mbështetjen e dhënë dhe me këshillat shumë të vlefshme gjatë përgatitjes së studimit, ka kontribuar në të gjitha fazat e hartimit të këtij studimi. Ai gjithmonë ka gjetur kohën për të diskutuar gjatë mbi problematikat jo të pakta të studimit, duke qenë një shtysë dhe ndihmë

e vazhdueshme në përfundimin me sukses të tij. Një falënderim shkon edhe për Phd. Liridon Lika, profesor në Universitetin e Liezhit (Belgjikë) dhe atë të Mاستrihtit (Holandë), sugjerimet e të cilit ishin me vlerë dhe ndikuan pozitivisht në këtë libër.

Gjithashtu, nuk mund të lë pa falënderuar profesorët dhe kolegët e mi të Institutit të Historisë, për dashamirësinë e treguar në dhënien e mendimeve dhe këshillave në çdo rast si dhe për mbështetjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm për të ecur përpara në realizimin e këtij studimi. Një pjesë e tyre e lexuan me kujdes punimin dhe dhanë sugjerime me vlerë. Në mënyrë të veçantë, drejtuesen e Departamentit të Historisë së Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar, prof. asoc. dr. Ledia Dushku, e cila me profesionalizmin dhe skrupulozitetin e saj ka një kontribut të veçantë për përmirësimin e studimit. Po ashtu i detyrohem thellësisht Mirelës, Mimosës, Melit, Lindës dhe Ornelës, për ndihmën e dhënë që ky studim të merrte formë të plotë.

Së fundi, dua të shpreh veçanërisht mirënjohjen për familjen time që më ka mbështetur, ndihmuar e mirëkuptuar, duke qenë një burim i fuqishëm inkurajimi dhe frymëzimi në punën time shkencore.

Autorja